

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë,

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Që nga momenti që do të votojmë aktin e parë normativ në fund të seancës, por në njëjtën kohë edhe përgjegjësia e atij që u drejtohet qytetarëve dhe organit legjislativ nga ky podium, fiton një dimension tjetër nderi, por edhe përgjegjësie njëkohësisht. Tani që po nisim një rrugëtim në një stad më cilësor drejt Bashkimit European është momenti të mos kufizohemi në slogane dhe në simbolikë, por të bëhemi përditë edhe më shumë të tillë. Më lejoni t'ju kujtoj të gjithëve një thënie të Shën Ambrozit të Milanos, në shekullin IV pas Krishtit, i cili shërbeu si senator i Romës dhe më vonë si episkop i Milanos: “Kur je në Romë, duhet të sillesh si romanët. When you in Rome does as romans do”.

Pra, është momenti që të sillemi si europianë në konceptimin e politikave dhe në implementimin e tyre. A jemi ne të tillë? Më lejoni ta nis me deklaratat e mëngjesit të sotëm të kreut të qeverisë, i cili improvizoi një paketë të dytë rezistence në peshën e parashikimit të breshërisë së kritikave të drejta dhe kuptimplote që e prisnin sot në këtë seancë parlamentare. Midis të tjerash, me një dozë sarkazme dhe alegorie tha: “Qeveria e poshtër”. E përdor shpesh termin “e poshtër” për qeverinë e tij. Ky është një truk retorik i përdorur rëndom për të relativizuar thelbin e akuzës që i rëndon. Unë nuk besoj se ka një njeri me sensibilitet minimal social, socialist ose liberal për politikën që ndjek kjo qeveri.

Zotërinj, politikën tuaj nuk janë aspak europiane, politikën tuaj nuk janë aspak koherente, janë politika improvizimi, janë politika demagogjije, janë politika protagonizmi, janë politika shumë larg praktikave të ndjekura nga vendet e tjera. Përmenda në seancat e kaluara shembullin e politikave që ndërmori Gjermania, përmenda shembullin e SHBA-ve edhe të vendeve të tjera të

BE-së. Po ju përmend rastin më të ri, sot Kryeministrja e porsaemëruar e Anglisë prezantoi paketën e masave për vendin e saj. Shuma vjetore e faturës së energjisë dhe gazit për çdo familje mesatare nuk do të jetë mbi 2500 paund për energjinë elektrike dhe gazin. A e dini sa është e ardhura e familjes mesatare britanike, krahasuar me atë të Shqipërisë? Është të paktën mbi 7-8 herë më e lartë. A e kuptoni në çfarë niveli janë masat që po merrni ju?

Zonja Ministre, për këto masa që po merrni iu thoni qytetarëve dhe atyre që iu kanë votuar ju se kjo është për shkak të performancës brilante të tatimeve dhe doganave; jo, kjo ndodh në të gjitha vendet pak a shumë për shkak të rritjes së çmimeve, inflacionit. Për shkak të rritjes së çmimeve janë rritur me vlerë nominale edhe të ardhurat në buxhetin e shtetit. Rrjedhimisht ju jo vetëm që nuk i keni si rezultat i performancës, i keni si rezultat i taksave dhe i rritjes së çmimeve, por nuk jeni as të sigurtë që ta pohoni, jo më ta rishpërndani për shtresat në nevojë dhe për qytetarët e këtij vendi. Gjithashtu, ju vazhdoni me politikën tuajë refraktare ndaj çmimit të karburanteve. Sot çmimi i brendit është i njëjtë me atë të para invazionit rus në Ukrainë.

Shikoni dhe krahasoni çmimet! Mos u justifikoni se është shkak procesi ose koha! Të gjitha këto tregojnë se edhe realitetin nuk dini ta lexoni, por edhe nuk doni ta lexoni dhe nuk doni ta reflektoni atë në politikën tuajë. Mbi të gjitha, nëse doni të jemi europianë dhe të sillemi si të tillë, mos spekuloni. Kryeministri, i cili e ka nisur nga ky podium me pranga dhe vargonj, burg dhe ndëshkime, sepse për borxhe minimale për energjinë elektrike ka burgosur qytetarë, të cilët kanë gjetur edhe vdekjen në qeli, na përmendi sot prapë rastin e Zvicrës, sepse Zvicra paska vendosur të ndëshkojë me burgim deri në tre vjet qytetarët që vënë termostatin mbi 19 gradë. Së pari, duhet ta dimë se armiku i së vërtetës nuk është gënjeshtër, por gjysmë e vërteta. Dhe ju bëni politikë me gjysmë të vërteta.

Ishte vetëm një shkrim i një të përditshmeje zvicerane, e cila thotë se ka mendime midis shumë të tjerave edhe për masa të tjera, por ju e dini se sa e ndërlikuar është vendimmarrja në Zvicër, ku kërkohen referendume, ndërkohë që Kryeministri na sjell si shembull të zgjedhur nga realitetet e të gjitha vendeve të kontinentit evropian. Dhe për kë do të ndodhë kjo? Vetëm për ata që do të përdorin sistemin e ngrohjes me gaz. Këtu, zotërinj, po përfundoj me një propozim konkret. Periudha e vështirë që na pret përpara nuk është e shkurtër. Paralajmërimi i Langarit

vetëm para dy-tri orësh ishte se të paktën për dy vjetët e ardhshëm inflacioni nuk mund të vihet në kontroll. Do të dëshiroja të paralajmëroja të gjithë kolegët se duhet të jemi shumë të vëmendshëm.

U drejtohem kolegëve të opozitës, se duhet të mbledhim urgjentisht firmat, siç mendojnë ata se kanë ekspertizën më të madhe më të gjatë për ngritjen e një komisioni ad hock ose hetimor për aktivitetin dhe monitorimin e aktivitetit të të gjitha kompanive prodhuese dhe administruese të energjisë elektrike në vendin tonë. Skandalet dhe pazaret e së shkuarës së afërt, së sotmes dhe të ardhmes së afërt janë të përmasave të atilla dhe me kosto dramatike për ekonominë e vendit. Është emergjencë, sepse e dimë se kjo qeveri, e cila e ka në gjen tendencën kleptokratike, një krizë të tillë për qytetarët do ta shndërrojë në një shans për oligarkët, oborrtarët dhe për veten e tyre.

Prandaj, dëshiroj ta mbyll duke iu drejtuar ministres së Financave me një pyetje: a keni ju në plan, a mendoni të tatoni fitime të jashtëzakonshme të kompanive të ndryshme që, në fakt, janë klientët tuaj? Shumë vende aplikojnë tatim të jashtëzakonshëm për fitimet e jashtëzakonshme për kompani të caktuara gjatë periudhës së krizës. Faleminderit!